

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORT MBI MISIONIN

Aktiviteti 2.5.2: Vazhdim i përkrahjes në implementimin e Planit të Veprimit – llogaritë kombëtare vjetore dhe tremujore

Komponenti nr 2 Llogaritë Kombëtare

Misioni i udhëhequr nga
Clementina Ivan-Ungureanu,
Statistikat e Danimarkës

26 Tetor - 6 Nëntor 2015

IPA 2012

Clementina Ivan-Ungureanu

Statistics Denmark

Sejrøgade 11

DK-2100 Copenhagen Ø

Denmark

Tel: +

Email: clementina@ivan-ungureanu.ro

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
1. Komentet e përgjithshme	5
Vlerësimi dhe rezultatet	5
3. Konkluzionet dhe rekomandimet	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
Aneksi 1	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
Annex 2. Personat e takuar.....	12

Lista e Shkurtesave

ANA	Llogaritë Vjetore Kombëtare
BP	Bilanci i Pagesave
KME	Kategoritë e mëdha ekonomike
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
SHKF	Shpenzimet e Kapitalit Fiks
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IKN	Indeksi i Kostos të Ndërtimit
ESA 95	Sistemi Evropian i Llogarive 95
ESA 2010	Sistemi Evropian i Llogarive 2010
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
FBKF	Formimi Bruto Kapitalit Fiks
KFQ	Konsumi Final i Qeverisë
GFS	Statistikat Financiare të Qeverisë
SHKFEF	Shpenzimet e Konsumit Final të Ekonomive Familjare
KN	Konsumi i Ndërmjetëm
IÇIM	Indeksi i Çmimeve të Importit
IPA	Instrumenti Para Asociim-Stabilizimit
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
TI	Teknologjia Informativë
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
LLKT	Llogaritë Kombëtare Tremujore
BPVT	BPV Tremujor
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
MoU	Memorandum i Mirëkuptimit
LLK	Llogaritë Kombëtare
NACE rev.1	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev.1

NACE rev.2	Nomenkultura e veprimtarive ekonomike, rev.2
DLLK	Departamenti i Llogarive Kombëtare
NPISH	Institucionet Jo-profitabile në Shërbim të Ekonomive Familjare
NOE	Ekonomia e pavrojtuar
OJQ	Organizata joqeveritare
IÇP	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
H&ZH	Hulumtim dhe zhvillim
ASN	Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
STS	Statistikat Afat-Shkurta
SUT	Tabelat Ofruse-Përdoruese
TeR	Termet e Referencës

Përmbledhje ekzekutive

Objektivi kryesor i misionit aktual, në kuadër të komponentit 2 – Llogaritë kombëtare- të Projektit të Binjakëzimit, ishte përkrahja e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) në fushën e vlerësimit të BPV-së vjetore sipas qasjeve të prodhimit dhe të shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante, për vitin 2014, dhe rishikimin e të dhënave tremujore.

Gjatë misionit janë finalizuar vlerësimet e BPV 2014, të cilat ASK do t'i publikojë në Nëntor 2015. Kalkulimet janë bazuar në burimet e të dhënave në dispozicion, nga qarkullimi i ndërmarrjeve të ofuruar nga ATK, pasqyrat financiare të njësive financiare (Banka Qendrore, bankat e tjera komerciale dhe kompanitë e sigurimit), Bilanci i Pagesave (BP) i siguruar nga Banka Qendrore, shpenzimet dhe të ardhurat e qeverisë së përgjithshme të siguruara nga Ministria e Financave dhe të dhënat statistikore (Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve (ASN), çmimet si ICP-së, IÇK-së, Indeksi i Kostos së ndërtimit (IKN) dhe çmimet e bujqësisë).

Duke vepruar sipas planit të përpiluar vitin e kaluar, ASK ka përmirësuar diseminimin e BPV-së dhe do të publikojë për herë të parë vlerësimet sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante, në të njëjtën kohë. Vlerësimet e para për vitin 2014 kanë qenë në dispozicion në Qershor 2015 (si shum e BPV tremujore). Të dhënat tremujore do të rishikohen, bazuar në vlerësimet finale për vitin 2014.

1. Komente të përgjithshme

Ky raport mbi misionin është përgatitur në kuadër të Projektit të Binjakëzimit „Përkrahje për Statistikat”.

Objektivi kryesor i këtij misioni ishte përkrahja e ASK-së në vlerësimin e BPV 2014 sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës dhe partnerëve të tjerë (NI-CO/Statistikat e Finlandës/Istat/Statistikat e Lituanisë).

2. Vlerësimi dhe rezultatet

Misioni aktual është fokusuar në vlerësimin e BPV, në çmime aktuale dhe konstante, për vitin 2014. Vlerësimet janë bazuar në burimet e të dhënave në dispozicion. Burimet kryesore të përdorura për vlerësime janë:

- Qarkullimi i njësive jo-financiare, i siguruar nga ATK;

- Pasqyrat financiare të njësive financiare (Banka Qendore, bankat e tjera komerciale, kompanitë e sigurimit);
- Pasqyrat financiare të qeverisë sa i përket shpenzimeve dhe të ardhurave, të siguruara nga Ministria e Financave;
- Bilanci i Pagesave (BP) i siguar nga Banka Qendore e Kosovës
- Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve (ASN) për vitin 2014
- Të dhënat statistikore sa i përket çmimeve (Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP), Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), Indeksi i Kostos së Ndërtimit (IKN), Indeksi i Çmimeve të Importit (IÇIMP) dhe çmimet e outputit dhe inputit në bujqësi.

Në fillim të misioni ishin të gatshme rezultatet preliminare të ASN-së. Të dhënat janë analizuar, por janë gjetur disa mospërputhje, si: (i) vlera e qarkullimit ishte e ndryshme nga të dhënat e marra nga ATK; (ii) pjesa e konsumit të ndërmjetëm në output ishte një rezultat jo real. Në këto kushte, për vlerësimin e indikatorëve të llogarive kombëtare për njësitë jo-financiare është vendosur të përdoren të dhënat nga ATK-ja sa i përket qarkullimit dhe ndryshimeve në inventar. Vlerësimet janë bazuar në këto të dhëna dhe në strukturën e ekonomisë së vitit të kaluar.

Outputi i qeverisë është vlerësuar bazuar në qasjen e kostos, duke përdorur informacionet e detajuara nga Ministria e Financave. Është përdorur një klasifikim i ri i transaksioneve, bazuar në kodet e GFS-së të vendosura së bashku me Ministrinë e Financave gjatë misionit të mbajtur në Shtator 2015. Vlerësimi i konsumit të kapitalit fiks (KKF) është bërë sipas metodës PIM, të vendosur një vit më parë me përkrahjen e FMN-së.

Outputi i sektorit financiar është vlerësuar bazuar në të dhënat e ofruara nga Banka Qendore e Kosovës; FISIM është kalkuluar sipas ESA 2010, si shumë e interesit të bankës në kreditë minus interesin e SNA për të njëjtat kredi plus interesin e SNA në depozitet minus interesin e bankës për të njëjtat depozite. Eksporti i FISIM është vlerësuar duke përdorur shkallën referuese të jashtme ndërbankare, për kreditë e dhëna për jo-rezidentët (duke përfshirë ndërmjetësimet Financiare). Bazuar në të dhënat në dispozicion për rezervat e kredive sipas aktivitetit dhe llojit, FISIM është alokuar të përdoruesit e ndryshëm. FISIM i është alokuar industrive dhe përdoruesve (konsumi final i ekonomive familjare, konsumi final i qeverisë dhe eksporti). Vlerësimi në çmime konstante është bërë duke përdorur IÇK-në e përgjithshme.

Indikatorët e Llogarive Kombëtare të NPISH janë vlerësuar bazuar në pasqyrat financiare të këtyre njësive, të ofruara nga Ministria e Shërbimeve Publike.

Pasi nuk ka qenë e mundur të përdoren rezultatet e ASN-së, konsumi i ndërmjetëm i aktiviteteve jo-financiare është vlerësuar në bazë të të dhënave të siguruara nga ATK dhe pjesëmarrja e saj në outputin e vitit të kaluar.

Vlerësimet e outputit 2014 në çmime të vitit të kaluar janë bërë duke përdorur IÇP dhe IÇK korresponduese; për konsumin e ndërmjetëm, është përdorur pjesëmarrja e konsumit të ndërmjetëm në outputin e vitit të kaluar.

Konsumi Final i Ekonomive familjare (KFEK) është vlerësuar bazuar në qasjen e rrjedhës së mallrave duke përdorur modelin e kalkulimeve, të vendosur para një viti. Janë bërë disa përshtatje në mënyrë që të plotësohen kërkesat metodologjike të ESA 2010.

FBKF ka përfshirë investimet në makineri dhe pajisje, ndërtimtari dhe bujqësi, dhe kapitilazimin e shpenzimeve në H&Zh dhe në sistemin e armëve. Vlerësimet e ndërtimtarisë janë bazuar në metodën e inputit. Vlera e lëndës së parë, e marrë nga importet dhe prodhimi vendor (minus eksporti), përfaqëson konsumin e ndërmjetëm; kjo është përshtatur duke marrë parasysh taksat e importit, TVSH-në dhe marzhat e tregtisë. Outputi është vlerësuar bazuar në shkallën e konsumit të ndërmjetëm në output, që është konsideruar të jetë 70%.

Investimet në makineri dhe pajisje janë kalkuluar në bazë të të dhënave të doganës (duke supozuar që prodhimi vendor nuk ofron atë lloj produkti). Të dhënat janë grupuar sipas kategorive të mëdha ekonomike dhe kodet 41,42,52 dhe 53 janë përdorur për vlerësimin e FBKF-së. Të dhënat përfundimtare përfshijnë tarifatat doganore dhe taksat, e paguara për makineri dhe pajisje.

Vlerësimet e çmimeve konstante për ndërtimtari dhe investime në makineri dhe pajisje janë realizuar duke përdorur IÇIMP.

Të dhënat mbi importin dhe eksportin e mallrave janë siguruar nga Dogana; për shërbimet, janë përdorur të dhënat nga Bilani i Pagesave (BP). Vlerësimet e importit të mallrave në çmime të vitit të kaluar janë bazuar në IÇIMP; për eksportin e mallrave është përdorur IÇP korrespondues. Importi i shërbimeve në çmime konstante është vlerësuar bazuar në mesataren e IÇK-së së Gjermanisë, Shqipërisë dhe Maqedonisë, të cilët janë partnerët kryesorë komercialë të Kosovës; eksporti i shërbimeve është vlerësuar duke përdorur IÇK-në korrespondues.

3. Konkluzionet dhe rekomandimet

Gjatë misionit, janë ofruar rekomandime të detajuara lidhur me vlerësimet e BPV-së vjetore, sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve.

Është rekomanduar të përmirësohet organizimi i punës në statistikën ekonomike vjetore. Rezultatet e ASN-së, që janë burimi kryesor i të dhënave për vlerësimet vjetore të BPV-së, nuk janë përdorur për shkak të cilësisë së dobët të të dhënave. Është e domosdoshme të zhvillohet një plan i detajuar i punës për ASN me afatet kohore dhe përgjegjësitë, duke filluar me dizajnin e pyetësorit deri te publikimi i rezultateve, përfshirë vlerësimin e mostrës, organizimin e grumbullimit të të dhënave, futjen e të dhënave dhe procesin e validimit, metodat e peshimit dhe diseminimin e të dhënave. Rekomandohet të përmirësohet pyetësori dhe të lidhen të dhënat e kërkuara me formatet, që njësitë dorëzojnë në ATK.

Aneksi 1



Projekti i Binjakëzimit i BE-së

KS12 IB ST 01

Përkrahje për Statistikat

Termet e Referencës:

Komponenti 2: Llogaritë Kombëtare

Aktiviteti 2.5.2: Vazhdim i përkrahjes në implementimin e Planit të Veprimit – Llogaritë kombëtare vjetore dhe tremujore

Afatet:

TeR –data e finalizimit: 12 Tetor 2015

Fillimi / fundi i aktivitetit: 26 Tetor – 6 Nëntor 2015

Koha e raportimit: 13 Nëntor 2015

Rezultatet obligative të komponentit:

Rezultatet obligative	Intervenimi logjik	Standardet	Burimet e informacionit	Supozimet
2.5.2	Vazhdim i përkrahjes në implementimin e Planit të Veprimit – Llogaritë kombëtare vjetore dhe tremujore	Raporti i Misionit, ku përshkruhet puna e realizuar dhe që duhet të realizohet para aktivitetit të radhës, i publikuar në web faqen e projektit	- Raportet tremujore të Projektit të Binjakëzimit - Raportet e Misionit - Plani i veprimit i azhurnuar	- Kapacitet i mjaftueshëm i absorbimit - Numër i vogël i stafit i involvuar në implementim - Stafi punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes të misionëve

				• Qasje në statistikat primare të qarta • Termat e referencës, të përpiluara me kohë, që paraqesin në detaje detyrat, aktivitetet dhe agjendën
--	--	--	--	---

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: 2.5.2

Përkrahja e mëtejme e ASK-së, përfshirë konsultimet dhe diskutimet me departamentin e llogarive kombëtare lidhur me përpilimin e llogarive vjetore dhe tremujore.

Ky mision është vazhdim i misionit të kaluar për përmirësimin e llogarive kombëtare në Kosovë.

ASK do të publikojë, për herë të parë, BPV-në vjetore sipas qasjes së prodhimit dhe të shpenzimeve në të njëjtën kohë, në fillim të nentorit 2015. Do të bëhet publikimi për përdoruesit, që paraqet vlerësimet e BPV-së vjetore.

për Kosovë për periudhën 2010- tremujori I 2014. Ky mision është fokusuar në vazhdimin e procesit të ciklit të prodhimit për këto statistika dhe vlerësimet e tremujorit të katërt të vitit 2014 dhe vlerësimet e përkohshme të BPV vjetor 2014 (si shumë e tremujoreve) që është planifikuar të publikohet në Qershor (12 Qershor 2015).

ASK-ja ka realizuar BPV tremujore gjatë periudhës 2014-2015 dhe serinë kohore 2010-tremujori i parë i vitit 2014, publikuar në dhjetor 2014ë tremujorët e tjerë të vitit 2014 janë publikuar gjatë semestrit të parë të vitit 2015. Në këtë mënyrë, për herë të parë, të dhënat tremujore për vitin 2014 janë publikuar para të dhënave vjetore. Të dhënat tremujore do të analizohen dhe rishikohen karshi vlerësimeve vjetore të BPV-së 2014.

Rezultatet e pritura nga aktiviteti 2.5.2

Raporti i Misionit

Publikimi për BPV-në vjetore

Stafi i ASK:

Xhevdie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare, xhevriefetahu@gmail.com, ASK

Ylli Shala, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ylli.Shala@rks-gov.net

Ilir Mazrekaj, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, ilir.mazrekaj@gmail.com

Emine Bajrami, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, alzana76@gmail.com

Florije Krapi, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Florije.Krapi@rks-gov.net,

Nysret Sylejmani, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, nysretsylejmani8@gmail.com

Besim Mehmeti, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Besim.Mehmeti@rks-gov.net

Ilir.T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarite Kombetare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit i ASK-së:

Udhëheqës i Projektit në ASK, Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Homologu i RTA, Znj. Teuta Zyberi, Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë, teuta.zyberi@rks-gov.net

Ekspertët e vendeve anëtare:

Znj. Clementina Ivan-Ungureanu, Eksperte, Statistikat e Danimarkës, clementina@ivan-ungureanu.ro

Stafi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA pkn@dst.dk

Znj. Nora Zogaj, RTA asistente, zogaj.nora@gmail.com

Përshkrimi i historikut për aktivitetet

Raporti i Vlerësimit të Adaptuar Global i vitit 2012 (AGA) i përgatitur nga Eurostat-i deklaroi në lidhje me Llogaritë Kombëtare (f. 53-54): Në vitin 2010, ASK, me mbështetjen e IPA, ka përgatitur një Plan të veprimit për përpilimin dhe publikimin e statistikave të plota për llogaritë kombëtare dhe tregun e punës. Ky plan është në parim një instrument i dobishëm për organizimin dhe zhvillimin e ardhshëm të Llogarive Kombëtare së bashku me zhvillimin e standardeve dhe burimeve, që janë të nevojshme për rritjen e mbulueshmërisë dhe përmirësimin e të dhënave të llogarive kombëtare.

AGA më tej deklaroi që Llogaritë Kombëtare duhet të marrin të dhëna të cilësisë së lartë nga fusha të ndryshme statistikore, në veçanti nga statistikatat e biznesit.

Aktivitetet e pritura janë:

- Përkrahja në vlerësimin e BPV vjetore 2014 dhe publikimi
- Përkrahja në rishikimin e mëtejshëm të BPV tremujore 2014
- Diskutime rreth ciklit të prodhimit dhe politikës së rishikimeve për llogaritë tremujore

Rezultatet e pritura:

- Raporti i misionit – sipas mostrës
- Rekomandimet për aktivitetet e mëtejshme për përmirësimin e llogarive kombëtare

Aneksi 1. Programi, Nëntor 2015

Day	Place	Time	Event
1	ASK	09.00	Planifikimi i javës
		09:30 – 16:00	Vlerësimet e BPV vjetore 2014 sipas qasjes së prodhimit, në çmime konstante dhe aktuale
2	ASK	09:00-16.00	Vlerësimet e BPV vjetore 2014 sipas qasjes së prodhimit, në çmime konstante dhe aktuale - vazhdim
3	ASK	09:00-16.00	Vlerësimet e BPV vjetore 2014 sipas qasjes së shpenzimeve, në çmime konstante dhe aktuale
4	ASK	09:00-16.00	Vlerësimet e BPV vjetore 2014 sipas qasjes së shpenzimeve, në çmime konstante dhe aktuale – vazhdim
5	ASK	09:00-16.00	Balancimi i BPV vjetore sipas qasjes së prodhimit dhe të shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante
6	ASK	09:00-16.00	Balancimi i BPV vjetore sipas qasjes së prodhimit dhe të shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante - vazhdim
7	ASK	09:00-16.00	Rishikimi i BPV tremujore 2014 bazuar në të dhënat vjetore
8	ASK	09:00-16.00	Rishikimi i BPV tremujore 2014 bazuar në të dhënat vjetore – vazhdim
9	ASK	09:00-16.00	Përgatitja e publikimit të BPV vjetore për vitin 2014
10	ASK	09:00-16.00	Rekomandimet Raportimi Takim: Ekspertët, udhëheqësi i komponentit, RTA

Aneks 2. Personat e takuar

ASK:

Llogaritë Kombëtare

Ilir Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare,

Xhevrie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare,

Ylli Shala, Ilir Mazrekaj, Emine Bajrami Florije Krap, Nysret Sylejmani, Besim Mehmeti

Ekipi i projektit:

Per Knudsen, RTA

Nora Zogaj, Asistente